



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/101
Datë: 22.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet 87 dhe 88 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/101

Datë: 22.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/101

Datë: 22.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Bashkëpunim Kulturor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës.
2. Përgjatë negocimit të kësaj Marrëveshjeje, obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/101

Datë: 22.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Paneli i Posaçëm (ad hoc) për identifikimin dhe rekomandimin e një (1) Hetuesi të përhershëm për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore, në kuadër të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), në këtë përbërje:

1.1. Këshilltar i Kryeministrit,	Kryesues;
1.2. Sekretar i Përgjithshëm i MI,	anëtar;
1.3. Këshilltar i Ministrit të MI,	anëtar;
1.4. Këshilltar i Ministrit të MPB,	anëtar;
1.5. Këshilltar i Ministrit të MF,	anëtar.
2. Paneli i Posaçëm (ad hoc) ka për obligim të identifikoj dhe t'i rekomandoj Qeverisë së Republikës së Kosovës kandidatin për Hetues të përhershëm për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore, në kuadër të KHAIA.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që të shpall konkurs publik për një (1) Hetues të përhershëm për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore, në kuadër të KHAIA.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/101

Datë: 22.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave shoqërore të evidentuara në emër të P.Sh. Shoqata Sh.A.M. Vllaznim Bashkim, të cilat ndodhen në parcelën kadastrale P-7207-0, vendi Lakrishtë, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, për nevoja të akomodimit të Institucionit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Republikës së Kosovës (TRUST), sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlerësimi i pronave do të kryhet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në Ministrinë e Financave, në përputhje me aktet nënligjore të miratuara në pajtim me paragrafin 6. të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.
3. Mjetet financiare për pagesën e kompensimit të pronarëve dhe shpenzimeve të procedurës së shpronësimit dhe vlerësimit do të sigurohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Republikës së Kosovës (TRUST).
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Fondi i Kursimeve Pensionale të Republikës së Kosovës (TRUST).
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/101

Datë: 22.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, sipas Kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë nr. 1924, datë 13.06.2016, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 18,333.00 (tetëmbëdhjetëmijetreqindetridhjetetë euro) për Shoqatën Ndërkomunale të të Verbërve nga Peja, për botimin e legjislacionit në alfabetin e Braillit.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën-programi Thesari me kod 11200 në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.
3. Mjetet e ndara nga pika 2. barten në llogarinë e Shoqata e të verbërve - Pejë, numri i certifikatës së regjistrimit të OJQ-së, 5102113-4, nr. fiskal 600247383, në numër të llogarisë bankare 17-02-2000020333.71 NLB Prishtina.
4. Përfituesi i mjeteve sipas këtij vendimi ka obligim vënien e emrit dhe logos së Qeverisë së Republikës së Kosovës në legjislacionin e botuar, si mbështetës financiar, si dhe pas përfundimit të botimit t'i paraqes raport me shkrim Qeverisë dhe Ministrisë së Drejtësisë për botimin e legjislacionit në alfabetin e Braillit.
5. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/101

Datë: 22.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, sipas Kërkesës me nr. protokolli 2273, datë 11.07.2016, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 10,000.00 (dhjetëmijë euro), për Qendrën për Studime dhe Shërbime Psikologjike dhe Sociale për përkrahjen e Projektit ATOMI.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave, në nën-programin Thesari me kod 11200 në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.
3. Mjetet e ndara nga pika 2. barten në llogarinë e Qendra për Studime dhe Shërbime Psikologjike dhe Sociale ENCOMPASS, numri i certifikatës së regjistrimit të OJQ-së, 5112606-8, numri fiskal 600507620, në numër të llogarisë bankare 150 109 000 177 2942 Raiffeisen Bank.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/101

Datë: 22.07.2016


Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 300,000 (treqindmijë euro), për aktivitetet lidhur me Kanonizimin dhe shpalljen e Shenjtërisë së Nënës Terezë, si në vijim:
 - 1.1. 200,000 € (dyqind mijë euro) nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës;
 - 1.2. 100,000 € (njëqindmijë euro) nga Ministria e Punëve të Jashtme, si më poshtë:
 - 1.2.1. 80,000 € (tetëdhjetëmijë euro) nga Kategoria Mallra dhe Shërbime, si vijon:
 - 20,000 €, nga nën programi, Drejtoria e Përgjithshme, kodi 14700;
 - 30,000 €, nga nën programi, Akademia Diplomatike, kodi 28000;
 - 10,000 €, nga nën programi, Shërbimet Konsullente, kodi 28600;
 - 20,000 €, nga nën programi, Ambasadat, kodi 14300;
 - 1.2.2. 20,000 € nga Shpenzimet Kapitale, nën programi, Administrata Qendrore me kod 11316, Projekti " Sistemi për Qendrën e vizave" me kod 14690;
2. Mjetet financiare nga pika 1 e këtij vendimi ndahen për Ministrinë e Punëve të Jashtme me kod 216, nën programi Administrata Qendrore me kod 11316, kategoria ekonomike Subvencionet dhe Transferet.
3. Mjetet financiare sipas këtij vendimi transferohen në Fondacionin "Drita" Prishtinë, numri i certifikatës së regjistrimit të OJQ-së, 5200269-9, numri fiskal 601250806, në numër të llogarisë bankare RBKOXKPR Acc: XK05 1501 0900 0365 5033 Raiffeisen Bank.
4. Ministria e Punëve të Jashtme do të organizoj dhe do t'i kryej veprimet e nevojshme lidhur me organizimin e ceremonisë.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/101

Datë: 22.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 16/2013 për Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/101
Datë: 22.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/87 i datës 13 maj 2016.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/101

Datë: 22.07.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Gjashtëmujor i Buxhetit për vitin 2016.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta procedojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, konform kërkesave të nenit 45 të Ligji 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë